REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primljeno/Pretato Recieved/Delivery 17 . 10 . 2018 vitit god year			
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	6059/2018		113

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 246 /2018
Datë: 02.10.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 dhe nenit 19 paragrafëve: 1, 5 nënparagrafit 5.1, 6 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi shqyrtoi raportin me rekomandimin e Kolegjit të Këshillit për mbikëqyrjen e procedurës së avancimit për pozitën "Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa" në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", Këshilli në mbledhjen e nëntëmbëdhjetë (XIX) të mbajtur më datë 02.10.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. **Anulohet si e parregullt** procedura e avancimit për pozitën "Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa", në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", sepse është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, si dhe të njëjtin t'ua dërgoj kandidatëve në procedurë të avancimit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Arsyetim

1. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 06.07.2018 nëpërmjet shkresës me numër protokolli 3818/2018 është njoftuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", për shpalljen e konkursit të brendshëm të datës 05.07.2018 deri më datë 20.07.2018 për pozitën "Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa", duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe shkresës së

aprovimit për autorizim të shpalljes publike të lëshuar me datë 28.06.2018 nga Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike.

2. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 10.07.2018 merr Vendimin me numër V.nr. 274/2018 me të cilin bënë emërimin e Kolegjit lidhur me mbikëqyrjen e procedurës së avancimit për pozitën "Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa".

3. Këshilli, ka konstatuar që kriteret kryesore të përcaktuara në konkursin e shpallur për "Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa" në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", kanë qenë:

   - *Diplomë Universitare, Fakulteti Ekonomik, Banka dhe financa;*
   - *Shatë (7) vite përvojë pune profesionale, prej tyre 4 vite provoj menaxheriale.*

4. Këshilli, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës së rekrutimit të dërguar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" më datë 16.08.2018, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", më datë 23.07.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 03-201 me të cilin ka themeluar Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil me këtë përbërje:

   1. *Fidan Hamiti-Menaxher i Personelit-UP-kryesues;*
   2. *Vaxhid Sadriu-Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Gjilanit-anëtar;*
   3. *Astrit Ademaj-Sekretar i Përgjithshëm ne Universitetin e Pejës-anëtar;*
   4. *Derya Kala-Menaxhere e Personelit ne Komunën e Mamushës-anëtare dhe*
   5. *Burim Berisha- Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Prizrenit-anëtar.*

5. Këshilli, ka konstatuar se për këtë pozitë ka shqyrtuar aplikacionet e pesë (5) kandidatëve si në vijim:
   1.*Halim Haziraj,*
   2.*Bajram Kolgeci,*
   3.*Denis Malta,*
   4.*Taulant Thaqi dhe*
   5.*Azem Ramadani.*

6. Këshilli, në bazë të dokumentacionit ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil më datën 27.07.2018 ka përgatitur listën e shkurtër prej tre (3) kandidatëve: Halim Haziraj, Bajram Kolgeci dhe Azem Ramadani.

7. Këshilli, ka konstatuar së të gjithë kandidatët e përfshirë në listën e shkurtër i plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurs ndërsa kandidati që nuk është përfshirë në listën e shkurtër nuk i plotëson kriteret e konkursit, dhe mbi bazë të kësaj konstaton se KPSHC ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

8. Këshilli, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, ka konstatuar se testi me shkrim është mbajtur më datë 01.08.2018, ku kanë marrë pjesë tre (3) kandidat, dhe që të gjithë kandidatët e kanë kaluar testin me shkrim.

9. Këshilli, gjatë shqyrtimit të testeve me shkrim të kandidatëve konstatoi se testi me shkrim ishte i përbërë prej tri (3) pjesëve dhe ka qenë i përpiluar në pajtim me nenin 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

10. Këshilli, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar se Vendimi i datës 23.07.2018 i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil ka qene në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet se : ***Institucionet themelojnë një Komision përzgjedhës Ad Hoc të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim : KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHCK përbëhet nga anëtaret të cilët kanë pozita më të larta, se pozita që duhet te rekrutohen, por një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor, KPSHC, zhvillon procedurat e rekrutimit për pozitën e karrierës dhe të jo karrierës".*** Mbi bazë të kësaj Kolegji për vëzhgim, ka konstatuar se në përbërjen e Komisionit dy prej anëtareve të Komisionit e kanë pozitën me ultë sesa pozita e cila është rekrutuar, konkretisht Kryesuesi Fidan Hamiti, Menaxher i Personelit në Universitetin e Prishtinës dhe anëtarja Derya Kala-Menaxhere e Personelit ne Komunën e Mamushës.

11. Bazuar në nenin 19 paragrafin 4 dhe 5 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryesuesja e Kolegjit për mbikëqyrje ka paraqitur raportin me rekomandimin që të anulohet si e parregullt procedura e avancimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Furnizim" në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti".

12. Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datën 14.09.2018 pasi shqyrtoj raportin e paraqitur nga Kolegji për mbikëqyrje, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

13. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës, Kryetari i Këshillit dhe personat kompetent i ndërmarrin veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Këshillit;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti"; dhe*
- *Arkivit të Këshillit.*

Eshref SHABANI

Kryetar i Këshillit